



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe neni 187, paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

V E N D I M

për bazën e llogaritjes, lartësinë, mënyrën e llogaritjes dhe mënyrën e pagesës së tarifës për mbajtjen e licencës së institucioneve pagesore, institucioneve të parave elektronike dhe operatorëve të sistemeve pagesore

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet baza për llogaritjen, shumën, mënyrën e llogaritjes dhe mënyrën e pagesës së tarifës që Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore), e paguan për mbajtjen e licencës për ofrimin e shërbimeve pagesore nga institucionet pagesore dhe institucionet e parave elektronike dhe për mbajtjen e licencës për operator të sistemit pagesor.

Banka Popullore paguan tarifën nga paragrafi (1) i kësaj pike për mbulimin e shpenzimeve faktike të realizuara për mbikëqyrjen e institucioneve pagesore, institucionet e parave elektronike dhe operatorët e sistemit pagesor në pajtim me Ligjin e Shërbimeve Pagesore dhe të Sistemit Pagesore (në tekstin e mëtejme: Ligji).

II. PËRKUFIZIME

2. Disa shprehje të përdorura në këtë vendim kanë këtë kuptim

2.1. "Subjekte të obliguara" janë institucionet pagesore, institucionet e parave elektronike dhe operatorët e sistemit pagesor, të cilave Banka Popullore u ka lëshuar licencë për ofrimin e shërbimeve pagesore, përkatësisht lëshimin e parave elektronike dhe licencën për operator të sistemit pagesor.

2.2. "Tarifë" është shuma që llogaritet për një vit kalendarik, në mënyrën e përcaktuar në kreun IV të këtij vendimi dhe ngarkohet për mbajtjen e licencës së subjekteve të obliguara.

III. BAZA E LLOGARITJES

3. Baza e llogaritjes së tarifës vjetore është shuma e kostove faktike të kryera për mbikëqyrjen e subjekteve të obliguara në një vit kalendarik.

Tarifa vjetore llogaritet kur baza për llogaritjen nga paragrafi (1) i kësaj pike zvogëlohet për shumën e tarifave të ngarkuara nga Banka Popullore, për shqyrtimin e kërkesave për dhënie të licencave dhe/ose pëlqimeve të subjekteve të obliguara, në pajtim me aktin nënligjor për llojin dhe lartësinë e tarifave për shërbimet e ofruara nga Banka Popullore.

Tarifa vjetore llogaritet në nivel të dy grupeve të subjekteve të obliguara, edhe atë:

- institucionet pagesore dhe institucionet e parave elektronike, dhe
- operatorët e sistemit pagesor.

Tarifa vjetore nga paragrafi (3), nënparagrafi 1) të kësaj pike, ndahet veçmas mes institucioneve pagesore dhe institucioneve të parasë elektronike në pajtim me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në numrin total të institucioneve pagesore dhe institucioneve të parave elektronike, të regjistruara në regjistrat përkatës gjatë vitit kalendarik.

IV. SHUMA DHE MËNYRA E LLOGARITJES SË TARIFAVE

4. Tarifa vjetore nga pika 3), paragrafi (4) të këtij vendimi, i cili ndahet veçmas për institucionet pagesore dhe institucionet e parave elektronike, që ofron edhe shërbime pagesore, në lartësi të barabartë me shumën e pjesës fikse dhe të ndryshueshme, edhe atë:

a) pjesa fikse llogaritet ashtu që 10% nga shuma e tarifës vjetore që u shpërndahet institucioneve pagesore në pajtim me pikën 3), paragrafi (4) të këtij vendimi përpjesëtohet me numrin e institucioneve pagesore të regjistruara në regjistrat;

b) pjesa e ndryshueshme llogaritet ashtu që 90% nga shuma e tarifës vjetore, që u shpërndahet institucioneve pagesore në pajtim me pikën 3), paragrafi (4) të këtij vendimi, i shpërndahet institucionit individual pagesor dhe institucionin e parave elektronike, që ofron edhe shërbime pagesore duke zbatuar kriteret e mëposhtme:

- 50% i shpërndahet institucionit individual pagesor dhe institucionit të parave elektronike, i cili gjithashtu ofron shërbime pagesore në përqindje të barabartë me përqindjen e pjesëmarrjes së numrit të transaksioneve të saj pagesore, në totalin e transaksioneve pagesore të të gjitha institucioneve pagesore dhe institucioneve të parasë elektronike, që ofrojnë edhe shërbime pagesore gjatë vitit kalendarik;
- 50% i shpërndahet institucionit individual pagesor dhe institucionit të parasë elektronike, i cili gjithashtu ofron shërbime pagesore në përqindje të barabartë me përqindjen e vlerës së transaksioneve të saj pagesore, në vlerën totale të transaksioneve pagesore të kryera të të gjitha institucioneve pagesore dhe institucioneve të parave elektronike, që ofrojnë edhe shërbime pagesore gjatë vitit kalendarik.

5. Tarifa vjetore nga pika 3), paragrafi (4) të këtij vendimi, e cila u ndahet veçmas institucioneve të parave elektronike, i ndahet institucionit individual të parasë elektronike, në shumë të barabartë me lartësinë e pjesëve fikse dhe të ndryshueshme, edhe atë:

a) pjesa fikse llogaritet ashtu që 10% nga shuma e tarifës vjetore, që u shpërndahet institucioneve pagesore në pajtim me pikën 3), paragrafi (4) të këtij vendimi përpjesëtohet me numrin e institucioneve pagesore të regjistruara në regjistrat;

b) pjesa e ndryshueshme llogaritet ashtu që 90% nga shuma e tarifës vjetore, që u shpërndahet institucioneve pagesore në pajtim me pikën 3), paragrafi (4) të këtij vendimi i shpërndahet institucionit individual të parave elektronike në përqindje të barabartë me pjesëmarrjen mesatare vjetore të parasë elektronike të papërdorur të emetuar prej tij, në totalin e emetuar të parasë elektronike të papërdorur nga të gjitha institucionet e parasë elektronike në vitin kalendarik.

6. Tarifa vjetore nga pika 3), paragrafi (3), nënparagrafi (2) të këtij vendimi i shpërndahet operatorit individual të sistemit pagesore, në shumë të barabartë me shumën e pjesëve fikse dhe të ndryshueshme, edhe atë:

a) pjesa fikse llogaritet ashtu që 10% nga shuma e tarifës vjetore e shpërndarë në operatorët e sistemeve pagesore, përpjesëtohet me numrin e sistemeve pagesore të regjistruara në regjistrin përkatës të menaxhuar nga subjektet e obliguara.

b) pjesa e ndryshueshme llogaritet ashtu që 90% nga shuma e tarifës vjetore e shpërndarë në operatorët e sistemeve pagesore i shpërndahet operatorit individual të sistemit pagesor duke zbatuar kriteret e mëposhtme:

- 50% i shpërndahet operatorit individual pagesor në përqindje të barabartë me përqindjen e pjesëmarrjes së numrit të transaksioneve të saj pagesore në totalin e transaksioneve pagesore të të gjithë operatorëve pagesorë që janë subjekte të obliguara gjatë vitit kalendarik;
- 50% i shpërndahet operatorit individual pagesor në përqindje të barabartë me përqindja e vlerës së transaksioneve të saj pagesore, në vlerën totale të transaksioneve pagesore të kryera të të gjithë operatorëve pagesorë që janë subjekte të obliguara gjatë vitit kalendarik.

7. Me qëllim të llogaritjes së lartësisë së tarifës totale nga pikat 4), 5) dhe 6) të këtij vendimi, Banka Popullore përdor të dhëna për numrin dhe vlerën e transaksioneve pagesore të cilat subjektet përgjegjëse ia dorëzojnë Bankës Popullore në pajtim me aktin nënligjor për përmbajtjen, mënyrën, formën dhe afatet e dorëzimit dhe publikimit të të dhënave dhe informatave për statistikën pagesore.

8. Në rast se shfaqet subjekt i ri i obliguar ose subjekti i obliguar pushon së ekzistuari gjatë vitit kalendarik, shuma e pjesës fikse të tarifës së subjektit të obliguar përcaktohet kur pjesa fikse e llogaritur e kompensimit në pajtim me pikat 4), 5) dhe 6) të këtij vendimi, ndahet në dymbëdhjetë muaj dhe shumëzohet me numrin e muajve, në të cilët subjekti i obliguar është regjistruar në regjistrin përkatës. Shuma e mbetur e pjesës fikse të tarifës shpërndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet subjekteve të tjera të obliguara, në pajtim me pikat 4), 5) dhe 6) të këtij vendimi.

9. Në rast se Banka Popullore pushon mbikëqyrjen e subjektit të obliguar për shkak të bashkimit të subjekteve të obliguara, tarifa që i detyrohet subjektit të obliguar që bashkohet, paguhet nga subjekti i obliguar me të cilin ai bashkohet.

10. Banka Popullore e përcakton lartësinë e tarifës të çdo subjekti të obliguar, sipas pikave 3), 4), 5) dhe 6) të këtij vendimi, për vitin paraardhës jo më vonë se data 30 qershor e vitit vijues.

Me përjashtim të paragrafit (1) të kësaj pike, Banka Popullore e përcakton lartësinë e tarifës së subjektit të obliguar që ka pushuar së ekzistuari në kohën kur Banka Popullore i ka hequr licencën.

V. MËNYRA E PAGESËS

11. Banka Popullore e dorëzon njoftimin e tarifës të subjektit të obliguar, në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e përcaktimit të lartësisë së tarifës..

Në njoftimin e tarifës nga paragrafi (1) i kësaj pike përcaktohet mënyra e pagesës.

Subjekti i obliguar është i detyruar të paguajë tarifën brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e marrjes së njoftimit të tarifës.

Nëse subjekti i obliguar nuk e paguan tarifën brenda afatit të përcaktuar në paragrafin (3) të kësaj pike, Banka Popullore përlogarit normën gjobë të interesit për vonesë të pagesës.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

12. Banka Popullore do të dërgojë njoftimet e para të tarifave për vitin 2023 më së voni deri më 31 korrik 2024.

13. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë të publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02-1364/3

16 janar 2023

Shkup

Guvernatorja

dhe kryesuesja

**e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска**